



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 600-27992 /2022

Klinë, dt. 04.08/2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, me dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 04.08.2022, mori;

V E N D I M

Për formimin e grupit punues për hartimin e draft buxhetit për vitin 2023

1. **CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e projektpropozimit- Draft Buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2023. Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
 - 1.1. **Xufe Kelmendi;**
 - 1.2. **Gjon Mrija;**
 - 1.3. **Osman Morina;**
 - 1.4. **Fjoralba Berisha, si dhe;**
 - 1.5. **Njomza Jaha.**
2. Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projektpropozimit- Draft Buxhetit për vitin 2023, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga diskutimet publike dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera qe dalin nga dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe autorizimeve tjera ligjore e nënligjore.
3. Me rastin e përgatitjes së draft buxhetit para datës 1 shtator duhet të njoftohet kryetari i komunës lidhur më projektpropozimin.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtoria e Financave;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.